



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA PATOS  
DREJTORIA E HARTIMIT TE PROJEKTEVE DHE MONITORIMIT TE  
INVESTIMEVE DHE SHERBIMEVE

Nr. 1394 Prot

Patos me 31/05 /2022



IRATOHET:  
KRYETARE  
Rajmonda BALILAJ

DETYRE PROJEKTIMI

Objekti: Permiresim i infrastruktures se Qendres Kulturore te Femijeve

Vendndodhja: Pallati i Kultures, "Lagjia e Re", Patos

Investitori:

Gjendja e Objektivit

Objekti ne shqyrtim, aktualisht me funksion Qender Kulturore per Femije, eshte njesi perberese e Pallatit te Kultures se Qytetit, e ndodhur ne pjesen jugperendimore te tij, me akses te vecante nga pallati ne pjesen perendimore. Siperfaqja totale e kesaj qendre eshte rreth 180 m<sup>2</sup>( perfshire pjesen e hyrjes), e ndare ne 3 klasa, 1 salle kercimi, 1 tualet, 1 depo, 1 zyre dhe pjesa e korridorit

Ne total godina e Pallatit te Kultures nuk ka patur nderhyrje rikonstruksioni pergjate viteve dhe po ashtu edhe Qendra Kulturore e Femijeve nuk i eshte nenshtuar ndonje nderhyrje per permiresimin e infrastruktures se saj. Keto ambiente nuk ofrojne kushtet e pershtatshme per plotesimin e funksionit te kesaj qendre dhe kjo eshte bere shkak per reduktimin e kapaciteteve te saj. Problematike ngelet amortizimi i dyerve/dritareve, shtresave te dyshemese, rifinitura e brendshme dhe ajo e jashtme, rrjeti elektrik i amortizuar, nyja sanitare teresisht jashte funksionit, mungesa e sistemit te ngrohjes/ftohjes, rrjetit telefonik dhe internet, MNZ etj

Qellimi i Projektit

Qellimi i këtij projekti është transformimi i ambienteve të kësaj qendre në ambiente funksionale, me kushte bashkëkohore dhe plotësimi me bazen materiale të nevojshme për kryerjen e aktiviteteve që parashikon kjo qendër.

#### **Objektivat:**

1. Përmirësim i infrastruktures, kushteve të mesimdhënisë dhe punës brenda kësaj qendre.
2. Zhvillim cilësor dhe rritje e kapaciteteve

#### Detyrat që duhet të zgjidhet projekti:

1. Zevendesim i shtresës ekzistuese të pllakave të dyshëmese.
2. Riparim i rifinitures së ambienteve të brendshme dhe të jashtme
3. Zevendesim i dyerve dhe dritareve ekzistuese
4. Instalimet e plota të rrjetit elektrik pasi ai ekzistues është i amortizuar
5. Plotësimin me rrjetin e nevojshëm telefonik dhe kompjuterik
6. Sistemi i kondicionimit të ambienteve i cili mungon plotësisht
7. Rikonstruksion i njëjës sanitare e cila është teresisht jashtë kushteve
8. Sistemi i mbrojtjes nga zjarri
9. Plotësimi me bazen materiale të nevojshme mobilie/instrumenta pasi ajo ekzistuese është e amortizuar dhe në mungesë.

Konceptoi:  
**Ing. Agim LISI**

**Dr. DREJTORISE SE HARTIMIT TE PROJEKTEVE DHE MONITORIMIT TE  
INVESTIMEVE DHE SHERBIMEVE**

**Ing. Arben MANOKU**

